



Strasbourg / Varshavë, 24 mars 2014

CDL-AD(2014)006

Opinioni nr. 755 / 2014 Or. Engl.

KOMISIONI EUROPIAN PËR DEMOKRACI PËRMES LIGJIT
(KOMISIONI I VENEDIKUT)

DREJTORATI I TË DREJTAVE TË NJERIUT (DDNj)
I DREJTORATIT TË PËRGJITHSHËM TË TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE
SUNDIMIT TË LIGJIT
TË KËSHILLIT TË EUROPËS

ZYRA E OSBE-së PËR INSTITUCIONET DEMOKRATIK DHE
TË DREJTAT E NJERIUT (OSCE/ODIHR)

OPINION I PËRBASHKËT

MBI DRAFT LIGJIN
MBI OBLIGIMET DISIPLINORE TË GJYQTARËVE

TË REPUBLIKËS SË MOLDAVISË

Adaptuar prej Komisionit të Venedikut në
sesionin e vet plenar të 98-të
(Venedik, 21-22 mars 2014)

Në bazë të komenteve nga
z. James HAMILTON (Anëtar zëvendësues, Irlandë)
znj. Hanna SUCHOCKA (Anëtare, Poloni)
z. Konstantine VARDZELASHVILI (Anëtar zëvendësues, Gjeorgji)
z. Mr. Nils ENGSTAD (Ekspert, DDNj, Norvegji)

Ky dokument nuk do të shpërndahet në takim. Ju lutemi sjellni këtë kopje.
www.venice.coe.int

Përmbajtja

I. Hyrje.....	3
II. Fushëveprimi i opinionit	3
III. Përmbledhja ekzekutive	3
IV. Analiza e Ligjit, nen për nen.....	5
A. Kapitulli I – Dispozitat e përgjithshme.....	5
B. Kapitulli II Bordi Disiplinor	9
C. Kapitulli III –Procedura e ekzaminimit të rasteve disiplinore	11
Seksioni I – Lajmërimi në lidhje me veprimet që mund të përbëjnë shkelje disiplinore	11
Seksioni 2 – Verifikimi i lajmërimeve	12
Seksioni 3 – Ekzaminimi i pranueshmërisë së lajmërimeve	12
Seksioni 4 – Ekzaminimi i rastit nga Bordi Disiplinor	12

I. Hyrje

1. Përmes letrës së datës 9 janar 2014, Ministri i Drejtësisë i Republikës së Moldavisë ka kërkuar nga Komisioni i Venedikut që të sigurojë një opinion për draft ligjin mbi obligimin disiplinor të gjyqtarëve (CDL-REF(2014)002).
2. z. James Hamilton, znj. Hanna Suchocka dhe z. Konstantine Vardzelashvili kanë vepruar si raportues për Komisionin e Venedikut. z Nils Engstad ka siguruar opinionin e ekspertit në bazë të kërkesës të Drejtoratit të të drejtave të njeriut (të Drejtoratit të Përgjithshëm të të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit, më tej DDNj). Pasi zyrja e OSBE për insitucionet demokratike dhe të drejtat e njeriut (OSBE/ZIDDNJ) ka shqyrtuar verzionin e mëparshëm të draft Ligjit në 2012¹, është dakorduar se OSBE/ ZIDDNJ gjithashtu do të merrte pjesë në përgatitjen e këtij opinion të përbashkët.
3. Delegacioni i Komisionit të Venedikut ka vizituar Chisinau, Moldavi, me 11-12 shkurt 2014 për t'u takuar me Komitetin për emërimet dhe imunitet të Parlamentit , anëtarët e grupit punues përgjegjës për draftim të Ligjit, këshillin superior të magjistratit, Ministrinë e Drejtësisë së Moldavisë dhe disa OJQ. OSBE / ZIDDNJ poashtu ka marrë pjesë në këtë vizitë.
4. Ky opinion i përbashkët merr parasysh informatat e fituara gjatë vizitës së lartpërmendur.
5. Opinioni i përbashkët aktual është adaptuar prej Komisionit të Venedikut në sesionin e vet plenar të 98-të (Venediku, 21-22 mars 2014).

II. Fushëveprimi i opinionit

6. Një prej brengave të ngritura gjatë takimeve të mbajtura në Chisinau është se neni 8 i draft Ligjit që krijon Bordin Disiplinor si një organ i pavarur do të ishte në konflikt me nenin 123 të Kushtetutës së Moldavisë.
7. Megjithatë, i takon gjykatës nacionale, në veçanti Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Moldavisë të vlerësojë përputhshmërinë e ligjeve nacionale me Kushtetutën e Moldavisë.
8. Roli i Komisionit të Venedikut dhe OSBE/ ZIDDNJ është të këshillojë për pajtimin e dispozitave të Kushtetutës dhe ligjeve tjera nacionale me standardet Europiane dhe zotimet e OSBE-së. Për këtë shkak, ky opinion i përbashkët do të trajtojë vetëm pajtimin e draft ligjit me standardet Europiane dhe të OSBE-s si dhe praktikat më të mira.
9. Komisioni i Venedikut, DDNj dhe OSBE/ZIDDNJ do të dëshironte të përmendë se ky opinion është pa ndonjë paragjykim ndaj çfarëdo rekomandimi me shkrim ose me gojë dhe komentet në Ligj ose legjislacionin tjetër të cilin mund ta zbatojë në të ardhmen Komisioni i Venedikut, DDNj dhe OSBE/ ZIDDNJ.

III. Përmbledhja ekzekutive

10. Shumë dispozita të përfshira në draft Ligj janë në linjë me standardet Europiane dhe ato të OSBE-së dhe kjo duhet të mirëpritet.

¹ Shih Opinioni i OSBE/ZIDDNJ për draft ligjin e Republikës së Moldavisë për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve, nr . JUD-MOL/217/2012 [LH], lëshuar me 14 dhjetor 2012.

Megjithatë, Komisioni i Venedikut, DBNj dhe OSBE/ ZIDDNj ka rekomanduar:

1. Rekomandimet kyçe

- A. Ndalimi eksplícit prej pozitës së gjyqtarit në rastet më serioze ose rastet e përsëritjes apo të mungesës së kapacitetit, ose sjelljes që i bën gjyqtarët të jenë të papërshtatshëm për kryerje të detyrave të tyre; [par. 42-43]
- B. Në draft Ligj të specifikohen kriteret për selektim të kandidatëve të anëtarëve të shoqërisë civile të Bordit Disiplinor si dhe mekanizmit për emërim dhe funksionim të Komisionit që është synuar ti selektojë ata; [par 53]
- C. Të deklarohet se anëtarët opsional duhet të veprojnë si zëvendësime për anëtarët që kanë dhënë dorëheqje apo që kanë abstenuar [par 63]
- D. Të kufizohet e drejta për dorëzim të lajmërimit të personave të cilët janë prekur prej veprimeve të gjyqtarëve ose për ata të cilët kanë pasur një formë të “ interesit ligjor” në çështje; [par 64]
- E. Të përforcohet roli i inspektorëve –gjyqtarëve dhe në veçanti t’u ipet atyre përgjegjësia e draftimit të akuzave; [par 71]
- F. Dhënia e të drejtës gjyqtarit për të kërkuar dëgjimin e dëshmitarëve ose personave tjerë gjatë ekzaminimit të rastit disiplinor; [par 78]
- G. Të shtohet një dispozitë e qartë që do të parandalonte anëtarin e njëjtë të Këshillit superior të magistratëve prej angazhimit në të gjithë hapat konsektiv të procedurave disiplinore (duke përfshirë procedurat e apelimit) ; [par 83]

2. Rekomandimet shtesë

- H. Në mënyrë eksplícite të referohet *synimi dhe neglizhenca* në kundërvajtje të përshtatshme në nenin 4.1 .a dhe nenin 4.1.b;
- I. Të përmirësohet neni 4.1.d duke i ndaluar gjyqtarët prej ndërhyrjes “ së paligjshme” në aktivitetet gjyqësore të gjyqtarëve tjerë; [par 24]
- J. Të bashkohet neni 4.1.g, neni 4. 1. i dhe neni 4. 1. j në një nen të vetëm për “vonesat e paligjshme dhe mangësitë në kryerjen e detyrave”; [par 25]
- K. Të fshihet neni 4.1.m, ose të ndryshohet dhe të bashkohet me nenin 4.1; [par 26]
- L. Të qartësohet teksti i neneve 4.1.o dhe 4.1 p; [par. 31-33]
- M. Të ndryshohet neni 4.2 ashtu që procedurat disiplinore të inicohen vetëm në raste ku përfshihet sjellja e pafalshme profesionale; [par. 35-36]
- N. Të rritet lista e sanksioneve nën nenin 6 duke shtuar sanksionet tjera të mundshme, përderisa specifikohet se disa sanksione sikurse reduktimi i pagës mund të aplikohet vetëm në rast të keqbërjes së qëllimshme; [par 38 dhe 41]
- O. Të rishqyrtohet ndalesa në transfere të gjyqtarëve gjatë periudhës së sanksioneve disiplinore; [par 45]
- P. Të ndryshojë neni 11.2 ashtu që vet Bordi Disiplinor të mund të shkarkojë anëtarët të cilët dështojnë të përmbushin detyrat e veta dhe të paracaktohet urdhëri në të cilin do të emërohen anëtarët opsional në raste të tilla; [par. 56-57]

- Q. Të sigurohet procedura që duhet të përcillet në rast të revokimit të lajmërimit dhe në mënyrë eksplicite të përmendet se duhet të ketë interes publik në zhvillimin e procedurave disiplinore; [par 67]
- R. Të sigurohet se vendimet për panele pranuese t'i komunikohen gjyqtarit përkatës; [par 75]
- S. Të sigurohet se çdo apelim kundër procedurave disiplinore duhet të parandalojnë vendimin final para se të përcaktohet apelimi; [par 81]
- T. Detajimi i procedurës para Këshillit superior të magjistratit ; [par 81] dhe
- U. Të shtohet dispozita për publikimin e vendimeve finale. [par 85]

Komisioni i Venediktu, DBNj dhe OSBE/ ZIDDNj mbeten në dispozicion për autoritetet Moldave në lidhje me çfarëdo asistence të nevojshme.

IV. Analizat e Ligjit nen për nen

11. Ky opinion është bazuar në përkthimin e gjuhës angleze të draft ligjit. Përkthimi mund të mos ketë reflektuar me saktësi versionin origjinal në të gjitha pikat dhe komentt specifike mund të rezultojnë prej përkthimit jo-korrekt.

A. Kapitulli I – Dispozitat e përgjithshme

12. Neni 2 përcakton “ parimet e procedurës për rastet disiplinore të gjyqtarëve”. Këto parime (ligjshmëria, respekti për pavarësi gjyqësor, proporcionaliteti i sanksioneve për veprën e kryer penale, transparenca) janë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe duhet të mirëprehen.

13. Neni 3 për “Bazën e obligimeve disiplinore” deklaron se “shkelja e akteve tjera normative përbën shkelje disiplinore vetëm nëse shkelja është shkelje disiplinore sipas nenit 4 të këtij Ligji”. Ky nen duhet të mirëprehet vetëm nëse nuk e kufizon përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve.

14. Megjithatë, ngritet pyetja se çfarë duhet të jetë raporti ndërmjet ligjit penal ose administrativ dhe ligjit disiplinor kur një shkelje mund të jetë edhe penale ose administrative dhe shkelje disiplinore. Duket e dëshirueshme të sigurohet se kur ka një shkelje nën ligjin penal ose administrative si dhe nën ligjin disiplinor, atëherë procedura penale ose administrative duhet të ketë prioritet. Do të ishte e dobishme një dispozitë rreth asaj se çfarë veprimi disiplinor duhet të ndërmerret pasi të përmyllen procedurat dhe për suspendimin e përshtatshëm të dëgjimeve disiplinore poashtu.

15. Neni 4 numëron 16 lloje të sjelljes së keqe (akte, abstenime dhe lëshime) që përbëjnë shkelje disiplinore. Në përgjithësi, numërimi i një liste të gjatë të shkeljeve gtë shumta disiplinore specifike në vend të definicionit të përgjithshëm mund të duket shumë i paqartë, nëse një praktikë/ qasje e mirë është në përputhje me standardet ndërkombëtare ².

16. Pjesa më e madhe e shkeljeve disiplinore të numëruara janë në përputhje me standardet Europiane dhe ato të OSBE-së dhe nuk paraqitet ndonjë vërtetjtje. Disa prej tyre, megjithatë, nuk janë draftuar mjaftueshëm qartë ashtu që kërkesa për “ parashikueshmëri” e Gjykatës Europiane për të drejta të njeriut – që kërkon që sjellja e cila shkon deri në veprim disiplinor të definohet me qartësi të mjaftueshme ashtu që personi në fjalë ta ketë të mundur të parashikojë pasojat e veprimeve të tij/saj r.

²Shih Opinionin e VVJE nr3 (2002), paragrafet 63-65.

dhe kështu të rregullohet sjellja e tij/saj³ – mund të konsiderohet si e përmbushur.

17. Neni 4.1.a, përcakton shkeljen disiplinore si "*dështim në vrojtim të detyrës së abstenimit kur gjyqtari e di ose duhet të dijë rreth ekzistencës së një prej rrethanave të siguruara me ligj për abstenim, si dhe për përsëritje të deklaratave të pajustificuara të abstenimit në të njejtin rast, që ka efektin e shtyerjes së shqyrtimit të rastit.*"

18. Është shumë e pasigurtë se çka mendohet me deklaratat e përsëritura dhe të pajustificuara të abstenimit në të njejtin rast, që ka efektin e shtyerjes së shqyrtimit të rastit.

19. Dështimi për të abstenuar kur gjyqtari "*duhet ta dijë*" për ekzistencën e rrethanave specifike duket se përshkruan situatën kur dështimi bëhet përmes neglizhencës. Një "*abstenim i pajustificuar*" gjithashtu do të mund të bëhet për shkak të neglizhencës. Megjithatë, një neglizhencë e thjeshtë nuk mund të jetë shkas për veprime disiplinore. Vetëm dështimet e shkaktuara me qëllim ose prej neglizhencës së madhe do të mund të rrisnin veprimet disiplinore⁴. Me qëllim të shmangies së rrezikut të neglizhencës së gjyqtarit në këtë kontekst, neni 4.1. duhet të deklarojë se veprimet ose lëshimet mund të dërgojnë vetëm tek veprimet disiplinore kur shkaktohen me qëllim ose përmes neglizhencës.

20. Neni 4.1.b përcakton "aplikimi i qëllimshëm ose aplikimi me besim të keq ose neglizhenca e përsëritur e legjislacionit në kundërshti me praktikën gjyqësore uniforme" si shkelje disiplinore. Ky nen nuk është i qartë dhe do të mund të interpretohej në situata konkrete, në një mënyrë të tillë që do të dobësonte pavarësinë e gjyqtarëve në vend se ta garantojnë këtë.

21. Gjyqtari mund të mos jetë i kufizuar të aplikojë jurisprudencën ekzistuese. Thelbi i funksionit të tij/saj është të interpretojë në mënyrë të pavarur rregulloret ligjore. Ndonjëherë gjyqtarët mund të jenë të obliguar të aplikojnë dhe interpretojnë legjislacionin në kundërshti me "*praktikën gjyqësore nacionale uniforme*". Një situatë e tillë mund të shfaqet për shembull në kontekst të konventave ndërkombëtare dhe kur vendimet prej gjykatave ndërkombëtare që mbikqyrin konventat ndërkombëtare mund të ndryshojnë praktikën gjyqësore nacionale aktuale.

22. Interpretimi ligjor i siguruara nga gjyqtari në krahasim me jurisprudencën e vendosur, nuk duhet të bëhet bazë për sanksione disiplinore⁵ përveç nëse bëhet në besim të keq, me qëllim që të përfitojë apo të dëmtojë palën në procedurë ose si rezultat i neglizhencës së madhe. Përderisa gjyqtarët e gjykatave të nivelit të më të ulët duhet përgjithësisht të përcjellin jurisprudencën e vendosur, ata nuk duhet të ndalen prej sfidimit nëse sipas gjykimit të tyre ata mendojnë se kanë të drejtë të bëjnë një gjë të tillë.

23. Ky nen duhet të ri-përpilohet; do të mund t'i referohej keqdashjes ose neglizhencës duke përcjellur tekstin e Rekomandimit të Komitetit të Ministrave për pavarësi, efikasitet dhe përgjegjësi të gjyqtarëve që deklaron se "*interpretimi i ligjit, vlerësimi i fakteve ose peshimi i dëshmimeve të bartura prej gjyqtarëve për përcaktim të rasteve nuk duhet të rrisë obligimin civil ose disiplinor, përveç në*

³ Shih *N.F. v. Italy*, ECtHR Opinioni i 2 gushtit 2001 (Aplikacioni nr. 37119/97), paragrafet 29-30; *Volkov v. Ukraine*, ECtHR Opinioni i 25 majit 2013 paragrafet 173ff

⁴ OSCE/ODIHR Kyiv Rekomandimet për pavarësinë gjyqësore në Europën lindore, Kaukazin jugor dhe Azinë qendrore sugjerojnë në paragrafin 25 që procedurat disiplinore duhet të limitohen në "*instanca të supozuara të sjelljes së keqe profesionale që janë të mëdha dhe të pafalshme e gjithashtu që e sjellin gjyqësorin në diskreditim.*"

⁵ CM/Rec(2010)12E / 17 nëntor 2010 Rekomandimi i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare sa i përket gjyqtarëve: pavarësia, efikasiteti dhe përgjegjësitë (adaptuar nga Komiteti i Ministrave me 17 nëntor 2010 në takimin e 1098th të Zëvendës Ministrave), par 66 "*interpretimi i ligjit, vlerësimi i fakteve ose peshimi i dëshmimeve të bartura nga gjyqtarët për përcaktim të rasteve nuk duhet të rrisë obligimin civil ose disiplinor, përveç në raste të keqdashjes dhe neglizhencës.*" Shih gjithashtu Opinionin e përbashkët të Komisionit të Venedikut me OSBE për Ligjin Kushtetues të sistemit gjyqësor dhe statusin e gjyqtarëve të Kazakistanit që rekomandon "*procedurat disiplinore duhet të trajtojnë sjelljen e keqe profesionale të pafalshme mirëpo kurrë nuk duhet të shtrihen në diferencat e interpretimit ligjor të draft ligjit ose gabimeve gjyqësore.*"

raste të keqdashjes dhe neglizhencës⁶.” Ky rekomandim mund të mos respektohet në rast se bazohet në një përkthim të gabueshëm.

24. Neni 4.1.d përcakton "*ndërhyrjen e gjyqtarit në aktivitetin gjyqësor të gjyqtarit tjetër*" si shkelje disiplinore. Për shkak të qartësisë, termi "i paligjshëm" duhet të shtohet në fjali: ndërhyrja e paligjshme në aktivitetin gjyqësor të gjyqtarit tjetër.

25. Shkeljet e përshkruara në nenin 4.1.g, nenin 4.1.i dhe nenin 4.1.j duhet të mbulohen në një nen mbi "shtyerjet e paligjshme dhe mangësitë në kryerjen e detyrës".

26. Neni 4.1.m përcakton faktin e "*kryerjes së një veprimi me elemente të krimit ose shkeljes që ishte e dëmshme për prestigjin e drejtësisë*" si shkelje disiplinore.

27. Ky nen nuk është i qartë dhe duket se paraqet disa elemente penale në procedurën disiplinore. Procedura disiplinore nuk duhet të përzihet me procedurën penale, por, përkundrazi duhet të mbahet e ndarë.

28. Një sanksion disiplinor mund t'i shqiptohet një gjyqtari pas shfajësimit para gjykatës penale ose kur procedura penale kundër tij apo të saj është ndërprerë, por të tilla veprime disiplinore dhe procedura nuk duhet të shkelin supozimin e pafajësisë të dhënë me nenin 6.2 të Konventës Europiane për të drejtat e njeriut. "Organet disiplinore duhet të jenë në gjendje të krijimit të pavarur të fakteve të rasteve para tyre"⁷.

29. Fjalët "elementet e një krimi" duhet të hiqen. Në këtë rast, paragrafi do të thoshte "kryerjen e një akti ose shkelje, që ishte e dëmshme për prestigjin e drejtësisë" dhe për këtë arsye do të duket shumë sikurse neni 4.1.p i cili merret me "veprime që ndikojnë në nderin dhe integritetin profesional apo reputacionin / prestigjin e drejtësisë". Për këtë arsye rekomandohet të fshihet neni 4.1.m ose të bashkohet version i rishikuar i nenit 4.1.m me nenin 4.1.p.

30. "Përdorimi i shprehjeve të papërshtatshme në gjykimet apo arsyetimin e aktgjyqimeve qartazi në kundërshtim me arsyetimin ligjor, që mund të ndikojë në prestigjin e drejtësisë apo dinjitetin e pozitës së gjyqtarit;" është një vepër penale sipas nenit 4.1.o.

31. Baza "përdorimi i shprehjeve të papërshtatshme" dhe "arsyetimi padyshim në kundërshtim me gjykimin ligjor" duket të jetë shumë i gjerë dhe mund të bien ndesh me parimet e parashtruara në Rekomandimi CM / Rec (2010) 12, paragrafi 66, që dmth, se "[p] interpretimi i ligjit, vlerësimin i fakteve apo peshimi i provave të bartura nga gjyqtarët për të përcaktuar rastet nuk duhet të çojnë në përgjegjësi civile ose disiplinore, përveç në rastet e keqdashjes dhe neglizhencës së madhe".

32. Për më tepër, konceptet sikurse janë "prestigji i drejtësisë" ose "dinjiteti i pozitës së gjyqtarit" si kriter për vlerësim të përmbajtjes së gjykimet janë shumë të paqarta. Këto çështje nuk kanë mangësi vetëm në precizitet por janë edhe subjektive për sa i përket formimit të bazës për ankesa disiplinore. Neni 4.1.o duhet të ri-vizitohet dhe ose të qartësohet ose të largohet fare.

33. Shkelja "veprimet (tjera) që kanë ndikim në nderin ose integritetin profesional ose reputacionin / prestigjin e drejtësisë" (neni 4.1.p) kërkon një definicion më preciz, për të shmangur interpretimet e ndryshme dhe me gjasa konfliktuozë të kësaj dispozite.

⁶ Rekomandimi CM/Rec(2010)12, paragrafi. 66.

⁷ Shih gjykimin [Allen v. the United Kingdom \[GC\]](#), no. 25424/09 [GC], ECHR 2013, § 103, 104 dhe 124.

34. Sipas Nenit 4.2 “shkelja disiplinore do të bëhet nëse Kryesuesi dhe Zëvendës Kryesuesi i gjykatës do të [dështojë] të përmbushë detyrat e përcaktuara në nenin 16/1 të këtij Ligji nr. 514-XIII të 6 korrikut 1995 për organizatën gjyqësore në rast se ky dështim do të ndikojë në aktivitetin e gjykatës.”

35. Procedurat disiplinore duhet të inicohen në përgjithësi në raste të sjelljes së keqe profesionale që është e madhe dhe e pafalshme, duke sjellur gjyqësorin në diskreditim. Aplikimi i sanksioneve disiplinore në një akt që do të ndikonte shumë pak në “aktivitetin e gjykatës” është ekstrem. Neni 4.2 duhet të ndryshojë.

36. Për më tepër, neni 16/1 i Ligjit nr. 514-XIII liston fuqitë dhe përgjegjësitë e Kryesuesit dhe Zëvendës Kryesuesit të Gjykatave. Për këtë shkak, përcaktimi i çfarëdo dështimi për ekzekutim të shkeljes disiplinore, nëse në ndonjë mënyrë ka ndikuar në aktivitetin e gjykatës, do të ishte i paarsyeshëm. Për shembull, a duhet dështimi të sugjerojë “këshillit superior të magjistratit emërimin e një apo më tepër gjyqtarëve prej gjykatës si gjyqtarë hetues” (Art 16/1.e) ose dështimi për të përfaqësuar gjykatën e drejtësisë në lidhje me autoritetet publike dhe mediat masive” (neni 16/1.n) të përcaktohet si shkelje disiplinore?

37. Neni 6.1 përshkruan katër lloje të ndryshme të sanksioneve disiplinore domethënë paralajmërime, qortim, reduktime të pagës dhe largim prej zyrës.

38. Duke pasur një gamë të arsyeshme të sanksioneve të mundshme ndihmon në përputhjen me parimin e proporcionalitetit kur trupi kompetent duhet të vendosë për sanksion. Prej këtij pikëvështrimi, autorët e draftit mund të dëshirojnë të shtojnë: “suspendimin e përkohshëm prej zyrës” si një sanksion tjetër të mundshëm disiplinor. Sanksionet tjera të mundshme mund të jenë tërheqja e rasteve prej gjyqtarit ose bartja e gjyqtarit në detyra tjera gjyqësore⁸.

39. Duhet të përshëndetet se draft Ligji siguron që sanksioni që do të aplikohet duhet të jetë proporcional në shkeljen e kryer (shih nenin 2.d.) “*proporcionaliteti i sanksionit me shkeljen e kryer*” dhe neni 7.2): “*Sanksionet disiplinore do të aplikohen proporcionalisht në seriozitetin e shkeljes disiplinore të kryer nga gjyqtari dhe rrethanat e tij/ saj personale. Serioziteti i shkeljes disiplinore është përcaktuar nga natyra e veprimtimit të kryer dhe pasojat e prodhuara. Pasojat e prodhuara duhet të vlerësohen duke marrë parasysh efektet në njerëzit e involvuar në procesin gjyqësor në të cilin është kryer shkelja dhe pasojat për imazhin dhe prestigjin e gjyqësorit*”.

40. Mirëpo, teksti i nenit 6 do të mund të përmirësohet ende.

41. Sa i përket reduktimit të pagës, do të duhej të përkujtojmë se paragrafi 55⁹ i Rekomandimit CM/Rec(2010)12 kundërshton sistemet që bëjnë pagesën kryesore të gjyqtarëve të varur prej performancës. Për këtë shkak rekomandohet që të specifikohet se reduktimi i pagës mund të aplikohet vetëm në raste që kanë të bëjnë më tepër me performancën.

42. Për sa i përket “largimit prej zyrës”, neni 6.6 deklaron “largimi prej pozitës së gjyqtarit është në fakt përfundimi i të drejtës së gjyqtarit si rezultat i shkeljes disiplinore; propozimi për largim të gjyqtarit prej zyrës do të dorëzohet prej Këshillit Superior të Magjistratit, siç përcaktohet me ligj”. “Shkelja disiplinore” është mjaft tekst i paqartë kështu që një sanksion i tillë i fuqishëm dhe ky paragraf do të përfitonin prej detajimit të mëtejshëm.

⁸ CM/Rec(1994) 12/ 13 tetor 1994, parimi VI.

⁹ CM/Rec(2010)12E / 17 nëntor 2010 § 55 “Sistemet që bëjnë pagesën kryesore të gjyqtarëve të varur prej performancës duhet të shmangët pasi që ato do të mund të shkaktonin vështirësi për pavarësinë e gjyqtarëve.

Largimi duhet të rezervohet në shumicën e rasteve ose rasteve të përsëritjes. Gjithashtu do të mund të aplikohet në raste të mungesës së kapacitetit ose sjelljes që i bën gjyqtarët të papërshtatshëm të kryejnë detyrat e tyre¹⁰.

43. Neni 6.2 dhe neni 6.7 trajtojnë sanksionet që mund të aplikohen për kryesues ose zëvendës kryesues të gjykatës. “Për gjyqtarë të cilët veprojnë si kryesues ose zëvendës kryesues të gjykatës përveç sanksioneve të specifikuar në paragrafin 1, sanksioni i largimit të kryesuesit dhe zëvendës kryesuesit prej zyrës gjithashtu mund të aplikohet.” Largimi prej zyrës i kryesuesit dhe zëvendës kryesuesit do të aplikohet për shkelje disiplinore të paracaktuar në nenin 42 të këtij Ligji dhe përbën ndërprerjen e mandatit të kryesuesit dhe zëvendës kryesuesit. Propozimi për largim prej të kryesuesit dhe zëvendës kryesuesit prej zyrës duhet të dorëzohet nga Këshilli Superior i Magjistratit, siç përcaktohet me ligj.”

Neni 4.2 i referohet listës së të drejtave dhe detyrave të kryesuesit dhe zëvendës kryesuesit të Gjykatës siç përcaktohet në nenin 16/1 të draft ligjit nr. 514-XIII të datës 6 korrik 1995 për organizatën gjyqësore. Dështimi për të plotësuar cilëndo prej kërkesave të kësaj liste nuk duhet të dërgojë automatikisht tek sanksioni disiplinor, e jo më tek largimi prej zyrës. Për këtë shkak sugjerohet që neni 6.7 të përpilohet në mënyrë më restrictive.

44. Siç përmendet më lartë, duhet të përhëndetet fakti se parimi i proporcionalitetit është reflektuar në draft Nenin 7.2.

45. Neni 7.5 siguron që “Gjatë periudhës valide të sanksionit disiplinor, gjyqtari nuk mund të transferohet, të emërohet si kryesues ose zëvendës kryesues i Gjykatës, ose të promovohet në ndonjë Gjykatë tjetër.” Përderisa ndalesa për promovion është e kuptueshme, ndalesa për transfere në gjykata tjera është më pak e qartë. Rekomandimi CM/Rec(2010)12 siguron se “[a] gjyqtari nuk duhet të pranojë një emërim të ri ose të bartet në zyre tjetër gjyqësore pa miratim, *përveç në raste të sanksioneve disiplinore* ose reformave të organizimit të sistemit gjyqësor “ (theksi i shtuar). Edhe nëse transferi nuk është shtuar si opsion i sanksionit disiplinor, ndalesa në transfere gjatë periudhës valide të sanksionit disiplinor ndoshta nuk është e nevojshme.

B. Kapitulli II Bordi Disiplinor

46. Krijimi i Bordit Disiplinor që është i ndarë prej Këshillit Superior të Magjistratit është për t’u përhëndetur. (neni 8.1).

47. Do të ishte e dobishme të harmonizohet ky nen- që definojnë Bordin Disiplinor si organ që ekzaminon rastet disiplinore dhe aplikon sanksionet disiplinore për gjyqtarët- me nenin 7 i cili deklaron se procedurat disiplinore do të mund të sjellen kundër *gjyqtarëve të larguar*.

48. Neni 9.1 definojnë përbërjen e Bordit Disiplinor (5 gjyqtarë dhe 4 persona prej shoqërisë civile). Një përbërje e tillë duhet të përhëndetet [asi që do të ndihmonte në sigurim të transparencës si dhe përfshirje të komunitetit në procedurat disiplinore, përderisa gjithashtu e parandalon rrezikun e korporatizimit gjyqësor¹¹.

49. Neni 9.3 siguron që konkurrenca do të organizohet të zgjedhë përfaqësuesit e shoqërisë civile për Bordin Disiplinor dhe kjo duhet të përhëndetet.

¹⁰ Është me rëndësi të sigurohet se “gjyqtarët do të jenë subjekt i suspendimit ose largimit vetëm për arsye të mungesës së kapacitetit ose sjelljes që i bën ata të papërshtatshëm për kryerje të detyrës së tyre” Parimet bazë të Kombeve të Bashkuara për pavarësinë e gjyqësorit, paragrafi 18.

¹¹ Shih *OSBE/ ZIDDNj Kyiv Rekomandime për pavarësinë gjyqësore në Europën Lindore, Kaukazin jugor dhe Azinë qendrore, paragrafi 9*.

50. Anëtarët do të selektohen për një afat të caktuar kohor prej gjashtë vitesh (neni 9.4) dhe kjo duhet të përshëndetet, poashtu.

51. Sipas Nenit 9.5 “mandati i zyrës së anëtarit të Bordit Disiplinor shtrihet de iure deri në themelimin e kolegjiutit në përbërje të re.” Rekomandohet që afati i anëtarëve të zgjatet deri në kryerjen e ekzaminimit të rasteve në të cilat është i përfshirë anëtari.

52. Neni 10.1 siguron që anëtarët e Bordit Disiplinor të gjyqtarëve do të zgjedhen prej Kuvendit të përgjithshëm të gjyqtarëve, si vijon: 2 gjyqtarë të gjykatës supreme, r gjyqtarë të Gjykatës së Apelit dhe 1 gjykatës prej gjykatave. Duhet të përshëndetet fakti se gjyqtarët janë zgjedhur nga kolegët e tyre. Megjithatë nuk është e qartë se çfarë arsytimi ka për përbërje të Bordit Disiplinor, kryesisht të përfaqësuesve të gjyqësorit të lartë. Pse kërkohet nga gjyqtarët të zgjedhin 4 prej 5 gjyqtarëve prej gjykatave supreme dhe asaj të apelit? Më tej, duhet të përmendet se zgjedhjet janë bërë me votim të fshehtë.

53. Neni 10.3 siguron që “Anëtarët e Bordit Disiplinor prej përfaqësuesve të shoqërisë civile duke përfshirë katër opsione, do të emërohen prej Ministrisë të Financave duke u selektuar përmes konkurrencës publike. Konkurrenca është organizuar nga komiteti për selektim të kandidatëve ku hyjnë përfaqësuesit e emëruar prej Këshillit Superior të Magjistratit. Përbërja numerike dhe nominale e Komisionit, mënyra e tij e funksionimit dhe kriteret për selektim të kandidatëve janë caktuar në Rregulloren për selektimin e anëtarëve të Bordit Disiplinor, të aprovuar nga Ministria e Drejtësisë, pas konsultimit me Këshillin Superior të Magjistratit”

54. Siç përmendet më lartë, organizimi i kompeticionit për zgjedhje të përfaqësuesve të shoqërisë civile për Bordin Disiplinor duhet të përshëndetet. Megjithatë, do të ishte e dëshirueshme që kriteret për selektim të kandidatëve si dhe mekanizmi për emërim dhe funksionim të Komisionit që është synuar për selektim të kandidatëve të specifikohet në ligj e jo në rregullore. Më tej, duhet të bëhet e qartë se funksioni i Ministrisë në emërimin e këtyre personave është formal dhe se emërimi është bërë në pajtim me rekomandimet e Komisionit që selekton kandidatët.

55. Neni 11.1.e deklaron se mandati i zyrës së anëtarit të Bordit Disiplinor mund të ndalojë apo të anulohet me një propozim të arsyetuar të Bordit Disiplinor, që është adaptuar përmes votës së 2/3 të anëtarëve, në rast të dështimit, për të përmbushur detyrat e anëtarit të Bordit Disiplinor të përcaktuar me këtë Ligj , për së paku 3 muaj. Referenca në votën e 2/3 të anëtarëve duhet të qartësohet për të parë nëse i referohet numrit total të anëtarëve apo atyre prezent dhe votues.

56. Sipas Nenit 11.2 propozimi i arsyetuar i Bordit Disiplinor për të anuluar mandatin e zyrës së Anëtarit të Bordit Disiplinor do të dorëzohet tek organi i cili ka emëruar ose zgjedhur atë anëtar me qëllim të anulimit dhe zëvendësimit të tij / saj me një anëtar tjetër. Bordi vet duhet të jetë në gjendje të shkarkojë anëtarin e jo thjeshtë ta dërgojë çështjen tek organi i cili ka zgjedhur anëtarin për anulim të emërimit. Kredibiliteti i Bordit Disiplinor do të mund të dëmtohej nëse ky organ dështon të veprojë ashtu. Megjithatë, ka nevojë të ketë një dispozitë të qartë për të nisur procedurën ku anëtari dështon të vijojë detyrat për të siguruar se është bërë paralajmërimi.

57. Neni 11.3 qe specifikon se “ në rast të përfundimit ose anulimit të mandatit të zyrës së anëtarit të Bordit Disiplinor, vendi i tij do të plotësohet nga një anëtar tjetër opsional “ duhet të shtohet se rrada e anëtarëve opsional duhet të para-caktohet me qëllim që të jetë e qartë se cili anëtar opsional do të plotësojë pozitën.

58. Zgjedhja e Kryesuesit të Bordit prej anëtarëve të tij, me votim të fshehtë, siguruar në nenin 12.1, duhet të përshëndetet. Megjithatë, do të ishte e dëshirueshme për Bordin të gjithashtu të zgjedhë Zëvendës- Kryesuesin për të vepruar në mungesë të Kryetarit në vend të aranzhimit të siguruar në Nenin 12.3 që në mungesë të Kryesuesit anëtari më i vjetër në moshë duhet të marrë përsipër kryesimin.

59. Për sa i përket dispozitës për largimin e Kryesuesit, si dhe propozimit të arsyetuar prej tre anëtarëve (neni 12.4) duhet gjithashtu të ketë një votë të anëtarëve të Bordit, të cilët nuk duhet të presin për tre muaj deri sa të ndërmarrin ndonjë veprim vet. 2/3 e shumicës do të mund të aplikonte sikurse në rastin e largimit të anëtarëve të zakonshëm.

60. Shpërndarja e zakonshme e rasteve e paraqitur në Nenet 12.2.b, 21.2 dhe 30 duhet të përshëndetet.

61. Për më tepër ka nevojë për sigurim të mekanizmit për vendim të reduktimit të barrës së madhe të punës së anëtarëve gjyqësor të Bordit Disiplinor (neni 13.3)

62. Neni 14.4 paraqet se “në rastin kur një Anëtar i Bordit Disiplinor deklaron abstenim, ai/ajo nuk mund të jetë i obliguar me vendim të Bordit të marrë pjesë në ekzaminimin e rastit për të cilin ai/ajo ka deklaruar abstenimin. “ Kjo dispozitë duhet të mirëpritet mirëpo duhet të referojë jo vetëm në rastet e abstenimit por gjithashtu edhe rastet e përjashtimit.

63. Megjithatë, duket se kundërshtohet prej paragrafit 5 i cili deklaron se “ Përjashtimi ose abstenimi nuk do të pranohen nëse si rezultat i abstenimit ose përjashtimit do të jetë e pamundur të sigurohet takimi i qëllimshëm i Bordit”. Një dispozitë e tillë nuk duhet të përdoret. Një anëtar opsional duhet të veprojë si zëvendësim për anëtarin e përjashtuar.

C. Kapitulli III – Procedura e ekzaminimit të rasteve disiplinore

Seksioni I – Lajmërimi në lidhje me veprimet që mund të përbëjnë veprime disiplinore

64. Neni 19 numëron personat ose organet me të drejtë të dorëzimit të “ lajmërimeve rreth veprimeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore”. Sipas Nenet 19.1 lajmërimi në lidhje me veprimet e kryera që mund të përbëjë shkelje disiplinore të kryer prej gjyqtarëve mund të dorëzohet prej “ cilitdo personi të interesuar”. Kjo e drejtë duhet të limitohet ose në persona që kanë qenë të ndikuar prej veprimeve të gjyqarit ose për ata të cilët kanë një formë të “ interesit ligjor” për çështjen.

65. Në këtë rast (nëse neni 19.1 a.) është ri-përpiluar me limitet e lartpërmendura, neni 19.2 i cili specifikon se “ se specifikimet nën paragrafin (1) mund të dorëzojnë lajmërimet në lidhje me veprimet që janë bërë të njohura për ata në ushtrimin e të drejtave të tyre ose funksioneve ose bazuar në informatat e shpërndara nga mediat “ mund të mbeten ashtu siç janë.

66. Megjithatë, duhet ta kemi parasysh se ka një rrezik potencial të keqpërdorimit të kësaj dispozite, pasi lajmërimet mund të dorëzohen pastaj vetëm në bazë të thashethemeve ose përmes qëllimeve keqdashëse që vënë presion të papërshtatshëm në gjyqtarin në fjalë.

67. Në nenin 19.4, dispozita që trajton rastin e revokimit të lajmërimit, duhet të specifikojë organin kompetent i cili do të vendosë për zhvillimin e procedurës disiplinore, procedurën që duhet të përcillet dhe duhet të deklarojë se duhet të ketë interes publik në procedurat disiplinore.

Seksioni 2 – Verifikimi i lajmërimeve

68. Sipas Nenit 21, lajmërimi për veprime që mund të përbëjnë shkelje disiplinore do të dorëzohet në Sekretariatit e Këshillit Superior të Magjistratit, i cili nuk bën hetime. Hetimet janë detyrë e gjyqtarëve –inspektor të cilëve rastet u shpërndahen në mënyrë të parregullt. Këto dispozita duhet të përsëriten.

69. Neni 23 definojnë se çka është “verifikimi i lajmërimit” dhe liston obligimet (neni 23.2) dhe të drejtat (neni 23.3) e gjyqtarit inspektor i cili ka detyrë të verifikojë lajmërimin. Neni 23.2 do të mundësojë të shtonte një referencë të dobishme në “ shpjegimet e siguruar nga gjyqtari” në listën e çështjeve që do të përfshihen në raport.

70. Neni 26 siguron se kur përfundon verifikimi, gjyqtari –inspektor do të përgatisë raportin i cili së bashku me dosjen e rastit disiplinor do të prezantohet (...) për ekzaminim në panelin pranues të Bordit Disiplinor (paragrafi 1). Raporti do të përmbajë një përshkrim të shkurtër të fakteve të supozuara prej autorit të lajmërimit , fakteve të identifikuar nga gjyqtari inspektor, dëshmia e prezantuar nga autori i lajmërimit dhe dëshmia e mbledhur gjatë verifikimit të kryer nga gjyqtari inspektor (paragrafi 2) . Shpjegimet e siguruar nga gjyqtari duhet të shtohen në këtë listë.

71. Neni 26 duket se e kufizon rolin e gjyqtarit –inspektor në përgatitjen dhe përmbajtjen e dosjes së rastit disiplinor. Gjyqtari –inspektor duhet të ketë rol të forcuar dhe në veçanti duhet të jetë përgjegjës për draftimin e akuzave disiplinore. Një dispozitë e tillë do të ishte e dobishme të shtohet në draft Ligj që është i heshtur për këtë aspekt të procedurës. Gjyqtari inspektor do të ishte vendi më i mirë për këtë pasë që paneli pranues duhet të veprojë vetëm si filter- duke vendosur për pranueshmërinë – mirëpo nuk duhet të jetë i përfshirë në draftimin e akuzave.

Seksioni 3 – Ekzaminimi i pranueshmërisë së lajmërimeve

72. Sipas Nenit 27, dosja pastaj ekzaminohet prej panelit pranues që përbëhet prej 3 anëtarëve (2 gjyqtarë, 1 përfaqësues i shoqërisë civile) i Bordit Disiplinor të caktuar me vendimin e Bordit Disiplinor (neni 27.1) i cili do të vendosë për pranimin ose refuzimin e lajmërimit (neni 27.2).

73. Neni 28 trajton ekzaminimin e pranueshmërisë së lajmërimit. Vendimi për pranueshmërinë duhet të adaptohet ashtu që së paku një anëtar i panelit ka votuar në favor të deklaramit të lajmërimit si i pranueshëm. Refuzimi i lajmërimit, në anën tjetër, kërkon një votë unanime (neni 28.4). Kjo duket se e balancon sistemin në favor të pranimit. Përderisa ky është një sistem i pazakonshëm, është e pranueshme që: t’i shpjegohet delegacionit gjatë misionit se kjo është kërkuar me qëllim që të sigurohet efikasiteti i panelit pranues dhe do të rriste përfshirjen e të gjithëve në punën e panelit.

74. Duhet të përsëritet fakti se vendimet që refuzojnë lajmërimin do të jenë të motivuara detyrimisht (neni 28.6).

75. Neni 28.7 duhet të sigurojë se vendimet e panelit pranues duhet të lajmërohen jo vetëm tek personi i cili ka dorëzuar lajmërimin, mirëpo edhe tek gjyqtari në fjalë.

Seksioni 4 – Ekzaminimi i rastit nga Bordi Disiplinor

76. Neni 30 siguron se rastet janë caktuar në mënyrë të parregullt nga Kryesuesi i Bordit tek anëtarët e Bordit të cilët do të jenë të emëruar si gjyqtarë raportues; jo shpërndarje duhet të mirëpritet. Megjithatë do të ishte e dobishme me qëllim të thjeshtimit të procedurës t’i besohet inspektorit-gjyqtar përgjegjës për rastin ta prezantojë atë para Bordit Disiplinor dhe të përmbushë detyrën e tij si gjyqtarë raportues.

77. Neni 31 që trajton pjesëmarrësit në rastin disiplinor (“ gjyqtari i referuar në rastin disiplinor, përfaqësuesi i inspektimit gjyqësor dhe personi i cili ka dorëzuar lajmërimin”) siguron në paragrafin 3 se “Mungesa e përsëritur dhe mungesa e ankesave që supozojnë se gjyqtari ose personi i cili ka dorëzuar lajmërimin ose përfaqësuesit e tyre në takim të Bordit Disiplinor nuk do të parandalojnë shqyrtimin e tij”. Kjo dispozitë duhet të përshëndetet pasi që është mjet parandalues përkundër mos-paraqitjeve obstruksioniste para Bordit.

78. Neni 31.5 më tej deklaron se “Anëtari i Bordit i caktuar si reporter apo cilido anëtar i Bordit Disiplinor mund të kërkojë dëgjimin e dëshmitarëve ose personave tjerë brenda takimit të ekzaminimit të rastit disiplinor”. Gjyqtari rasti i të cilit është shqyrtuar nga Bordi do të sigurohet me të drejta të ngjashme.

79. Neni 34 siguron se takimet e Bordit Disiplinor janë publike përveç nëse Bordi vendosë ndryshe, ose ex officio ose bazuar në kërkesën për sesion të mbyllur të gjyqtarit të referuar në rastin disiplinor, në interes të rendit publik ose sigurisë nacionale, ose kurëdo që është e domosdoshme të mbrohet privatësia në procedurat disiplinore. Kjo dispozitë duhet të përshëndetet pasi që specifikon se procedurat publike janë rregulla dhe se sesionet e mbyllura do të zhvillohen vetëm në rast se rrethanave specifike, pas vendimit të arsyeshëm të Bordit.¹²

80. Neni 35 I cili merret me diskutimin dhe adaptimin e Bordit Disiplinor duhet të specifikojë se gjyqtari raportues nuk duhet të merr pjesë në votimin e vendimit.

81. Neni 39.1 siguron se vendimet e Bordit Disiplinor do të mund të apelojnë në Këshillin Superior të Magjistratit dhe se vendimet e Bordit Disiplinor do të bëhen finale pas 15 ditësh prej pranimit të kopjes së vendimit të motivuar. Çdo apel kundër procedurave disiplinore duhet të parandalojë vendimin final derisa të përcaktohet apeli (jo vetëm vendimet për shkarkim të gjyqtarit prej zyrës së Kryesuesit të Gjykatës ose prej zyrës si gjyqtarë siç përcaktohet në nenin 38.2).

82. Procedura para Këshillit Superior të Magjistratit është përmendur shkurtimisht në nenin 39. Do të duhej të rregullohen në më tepër detaje për të siguruar për palët në rast një rishikim të drejtë dhe transparent gjyqësor.

83. Sipas dispozitës së këtij draft Ligji, duket se anëtari i Këshillit Superior të Magjistratit mund të dorëzojë një lajmërim për shkelje disiplinore (nën nenin 19.1 b) dhe më vonë apelimin kundër vendimit të Bordit Disiplinor (neni 39.1) kështu që sjellja e rastit para Këshillit Superior të Magjistratit , në të cilin ai ose ajo pastaj mund të votojë për apelim, së bashku më një anëtar tjetër të Këshillit Superior të Magjistratit (Neni 39.4). Me fjalë tjera draft Ligji aktual ka mungesë të një dispozite të qartë që do të parandalonte që anëtari i njëjtë i Këshillit Superior të Magjistratit të angazhohej në të gjithë hapat konsektiv të procedurës disiplinore që mund të ngrisë brenga rreth animit potencial dhe mungesën të paanshërisë. Për të shmangur këtë, rekomandohet që një ndalesë e tillë të shtohet në tekstin e Ligjit , përveç nëse tanimë është e specifikuar në një ligj tjetër (në këtë rast do të referohej ligji tjetër) .

84. Neni 40 siguron se vendimet e Këshillit Superior të Magjistratit mund të apelojnë në Gjykatën Supreme “ nga ana e personave që kanë dorëzuar ankesa, inspektime gjyqësore ose gjyqtarin në fjalë”. Nuk është e qartë pse inspektimi gjyqësor duhet të jetë i mundësuar në apelim.

¹² Shih OSBE/ ZIDDNj Kyiv Rekomandimet për pavarësinë gjyqësore në Europën Lindore, Kaukazin jugor dhe Azinë Qendrore , paragrafi 26.

Apelimi duhet të mundësohet për palët e përfshira- ankuesin dhe gjyqtarin në fjalë.

85. Përfundimisht, dispozita për publikimin e vendimeve finale duhet të shtohet në draft Ligj.

* * *